



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:071627

Datë: 29.07.2024

Numri i dokumentit: 05994588

C.A.P.nr.632/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, nga gjyqtari individual Adnan Konushevc, në çështjen përmbartimore të kreditores E.M nga fshati D..., Komuna e K..., ndaj debitores Komuna e Kaçanikut - Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, me bazë juridike kthim i punëtorit në vendin e punës dhe kompensim i të ardhurave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditores, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.1632/23 të datës 27.03.2023, me datë 19.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e kreditores E.M nga fshati D..., Komuna e Kaçanikut, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.1632/23 të datës 27.03.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin e atakuar E.nr.1632/23 të datës 27.03.2023, ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Kaçanikut-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë dhe ka shfuqizuar aktvendimin mbi lejjimin e përmbartimit E.nr.03/16 të datës 22.01.2016, për pagesën e të ardhurave personale për periudhën prej datës 09.11.2015 e deri me datës 22.10.2019, në shumë prej 27,359.00 euro, për pagesën e kontributit pensional, në shumë prej 3,075.00 euro dhe tatimit në burim në shumë prej 1,857.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditorja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovtoj ankesën si të bazuar, të prish aktvendimin e atakuar apo të njëjtin ta ndryshoj duke e aprovuar propozimin për përmbartim.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartues-vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Nr.794/09, të datës 21.04.2009. Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.03/16 të datës 22.01.2016, ka lejuar përmbartimin për kthimin e kreditores në vendin e punës në pozitën e Drejtorit të Qendrës së Edukimit dhe Arsimit Parashkollor “Agimi” në Kaçanik, si dhe pagesat e të ardhurave personale për pagesat e papaguara prej datës 01.10.2013, deri në kthimin e kreditores në vendin e punës. Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit debitorja ka ushtruar prapësim me datën 05.02.2016. Pas disa seancave të zhvilluara dhe vendimeve të nxjerra nga gjykata e shkallës së parë dhe të anuluar nga gjykata ankimore, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin E.nr.70/20 të datës 09.10.2020, ku e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar aktvendimin mbi lejimin e përmbartimit, i cili aktvendim është vërtetuar pjesërisht me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5793/20 të datës 17.04.2021, sa i përket kthimit të kreditores në vendin e punës, ndërsa çështja se është kthyer në rivendosje për pjesën që ka të bëjë me të ardhurat personale. Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkesave të lëndës ka nxjerr aktvendimin e atakuar duke pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar aktvendimin mbi lejimin e përmbartimit lidhur me kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i kreditores se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës dhe se dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin. Aktvendimi i atakuar nuk rezulton se është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktvendimit

është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me aprovimin e prapësimit si dhe shfuqizimin e aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka shfuqizuar aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit sa i përket pagesë së të ardhurave personale nga data 09.11.2015, e deri me datën 22.10.2019, pasi që duke u bazuar në pikën II të dispozitivit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Nr.794/09 të datës 21.04.2009, me të cilin si dokument përmbarues është obliguar debitorja-Komuna e Kaçanikut që në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, të kthej ankuesen këtu kreditorin-E.M, në vendin e punës Drejtor/e në Qendrën e Edukimit dhe Arsimit Parashkollor “Agimi” në Kaçanik, dhe të ja bëjë kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive nga data 15.12.2008, e deri sa nga autoriteti punëdhënës të bëhet përsëritja e konkursit dhe tërë procedura intervistuese dhe zgjedhja e kandidatës në bazë të meritës sipas vendimit të KPMK-së, të datës 15.04.2009 nr.782/09. Debitorja disa herë ka bërë shpalljen konkursit si dhe anulimin e këtyre konkurseve ndërsa shpalljen përfundimtare lidhur me rekrutimin për pozitën Drejtor/e i QEAP-së “Agimi”, në Kaçanik është bërë me datën 02.07.2015, ndërsa pas zhvillimit të të gjitha procedurave të rekrutimit me datën 29.07.2015, kryetari i Komunës së Kaçanikut e ka bërë njoftimin Nr.111-1888/2015, për kandidaten e suksesshme të rekomanduar nga komisioni përzgjedhës për N.K. Kundër njoftimit të kryetarit, kreditorja ka ushtruar ankesë pranë komisionit për zgjidhjen e ankesave dhe parashtresave, i cili komision me vendimin Nr.16-24524 të datës 31.08.2015, e ka refuzuar ankesën e kreditorës si të pabazuar. Më pas, kreditorja ka ushtruar ankesë në Inspektoratin e Arsimit-Sektori i Inspektoratit të Arsimit, ku të njëjtit me vendimin Nr.prot:2/871 të datës 23.10.2015, e kanë refuzuar ankesën e kreditorës si të pabazuar duke vlerësuar se procedura e rekrutimit për Drejtor në QEAP-së, është procedurë e rregullt dhe është bërë në pajtim me ligjin. Më tutje, kreditorja ka vazhduar me ankesë kundër vendimit të Inspektoratit të Arsimit edhe në KPMSHCK, ndërsa kjo e fundit me vendimin A02/442/2015, të datës 09.11.2015, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e kreditorës dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Parashtresave të Komunës së Kaçanikut. Gjykata e Apelit, vlerëson se në rastin konkret në bazë të shkresave të lëndës përkatësisht me vendimin A02/442/2015, të datës 09.11.2015 të KPMSHCK-së, me të cilin është refuzuar ankesa e kreditorës dhe është lënë në fuqi vendimi Nr.16-24524 i datës 31.08.2015, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kaçanikut, është përmbushur në tërësi vendimi Nr.794/09, të datës 21.04.2009, i cili paraqiste dokument përmbarimor (titull

ekzekutiv), në bazë të së cilit është inicuar procedua përmbimore dhe se i njëjti vendim nga data 09.11.2015, ka humbur fuqinë e tij ekzekutuese për shkak të përmbushjes.

Përkundër faktit se vendimi i KPMSHCK-së, është anuluar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.2064/15 të datës 15.08.2018, në riprocedurë KPMSHCK-ja ka nxjerr vendim të ri A.nr.580/18 i datës 05.10.2018, duke e vërtetuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Parashtresave të Komunës së Kaçanikut, duke legjitimuar edhe një herë procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor/e i QEAP-së “Agimi”, në Kaçanik. Nga të lartcekurat rezulton se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se për periudhën kontestuese nuk konsiderohet dokument përmbimor vendimi i KPMSHCK-së me numër 794/09 i datës 21.04.2009, pasi që i njëjti është zbatuar në tërësi nga debitorja dhe se kreditorës nuk i takon e drejta e kompensimit për periudhën kohore nga data 09.11.2015 deri me datën 22.10.2019, pasi që në këtë periudhë pozitën e Drejtorit e ka ushtruar kandidatja N.K, e cila ka qenë e përzgjedhur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga ana e debitorës.

Lidhur me pretendimet ankimore të kreditorës se në procedurën përmbimore gjykata duhet të verifikoj rregullsinë dhe ligjshmërinë e dokumentit përmbimor dhe kërkesat e saj për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës rrjedhin nga vendimi i KPMSHC-së, nr.794/09 i datës 21.04.2009, i cili vendim nuk është shfuqizuar asnjëherë deri me sot. Gjykata e Apelit vlerëson se është pretendim i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm, për faktin se gjykata në procedurën përmbimore nuk ka tagër të lëshohet në ligjshmërinë e dokument përmbimor pasi që në procedurën përmbimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbimor. Në bazë të lartcekurave rezulton se dokumenti përmbimor në këtë rast vendimi nr. nr.794/09 i datës 21.04.2009, është përmbushur nga debitorja dhe se i njëjti vendim nuk prodhon efekt juridik.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Cap.nr.632/2023 me datë 19.07.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci